

Niveli i studimeve: Bachelor

Lënda: Raportimi financiar II

Prof.dr.Muhamet Aliu

Ligjerata 6

Tema: Pasqyrimi i ngjarjeve pass datës së raportimit financiar

Objektivi

1. Objektivi i këtoj Standardi është që të parashikojë:
 - a) kur duhet të korigjojë pasqyrën e saj financiare një njësi ekonomike për ngjarjet pas datës së bilancit. dhe
 - b) informacionin shpjegues që duhet të japë një njësi ekonomike rreth të dhënave kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare dhe rreth ngjarjeve pas datës së bilancit.

Standardi kërkon që një njësi ekonomike të mos përgatisë pasqyrat e saj financiare mbi një bazë vijimësie nëse ngjarjet pas datës së bilancit dëshmojnë se hipoteza e vijimësisë nuk është e përshtatshme.

2. Ky Standard do të zbatohet për kontabilizimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të ngjarjeve pas datës së bilancit.

3. Në këtë standard termat e mëposhtme janë përdorur me këto kuptime:

Ngjarjet pas datës së bilancit i referohen atyre ngjarjeve të favorshme dhe të pafavorshme që ndodhin ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare. Janë identifikuar dy lloje ngjarjesh:

(a) ngjarjet që deshmojnë për kushtet që ekzistojnë në datën e bilancit (*korrigjimi i ngjarjeve pas datës së bilancit*); dhe

(a) ngjarjet që japin të dhëna për kushtet e krijuara pas datës së bilancit (*ngjarje të pakorrigjueshme pas datës së bilancit*);

4. Procesi i përfshirë në autorizimin e publikimit të pasqyrave financiare do të ndryshojë në varësi të strukturës drejtuese, kërkesave statutoire dhe procedurave të ndjekura në përgatitjen dhe përfundimin e pasqyrave financiare.

5. Në disa raste, një njësie ekonomike i kërkohet t'i paraqesë pasqyrat e saj financiare aksionerëve për miratim pas publikimit së pasqyrave financiare. Në raste të tilla pasqyrat financiare janë autorizuar për botim në datën e daljes, jo në datën kur aksionerët miratojnë pasqyrat financiare.

Shembull

Struktura drejtuese e një njësie ekonomike plotëson projekt-pasqyrat financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2011 më 28 shkurt 2012. Më 18 mars 2012, Bordi i Drejtorëve rishikon pasqyrat financiare dhe i autorizon ato për botim. Njësia ekonomike deklaron fitimin e saj dhe përzgjedh informacione të tjera financiare më 19 mars 2012. Pasqyrat financiare i jepen aksionerëve dhe të tjerëve më 1 prill 2012. Aksionerët miratojnë pasqyrat financiare në takimin e tyre vjetor më 15 maj 2012 dhe më pas pasqyrat financiare të miratuara depozitohen në një strukturë rregullatore më 17 maj 2012.

Pasqyrat financiare autorizohen për botim më 18 mars 2012, (data e autorizimit të Bordit të Drejtorëve për publikim).

6. Në disa raste strukturës drejtuese të një njësie ekonomike i kërkohet t'ia paraqesë pasqyrat e saj financiare një bordi mbikqyrës (të përbërë vetëm nga jo-ekzekutivë) për miratim. Në raste të tilla, pasqyrat financiare autorizohen për publikim kur struktura drejtuese autorizon dhënien e tyre për bordin mbikqyrës.

Shembull

Më 18 mars 2012, struktura drejtuese e njësisë ekonomike autorizon pasqyrat financiare për bordin mbikqyrës. Bordi mbikqyrës përbëhet vetëm prej personave jo-ekzekutivë dhe mund të përfshijë përfaqësues të punonjësve dhe të interesave të tjera të jashtme. Bordi mbikqyrës i miraton pasqyrat financiare më 26 mars 2012. Pasqyrat financiare i bëhen të ditura aksionerëve dhe të tjerëve më 1 prill 2012. Aksionerët miratojnë pasqyrat financiare në takimin e tyre vjetor më 15 maj 2012 dhe më pas pasqyrat financiare i çohen një strukture rregullatore më 17 maj 2012.

Pasqyrat financiare autorizohen për botim më 18 mars 2012, (data e autorizimit të strukturës drejtuese për dërgim në bordin mbikqyrës).

7. Ngjarjet pas datës së bilancit përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën kur janë autorizuar pasqyrat financiare, dhe në rast se ato ngjarje ndodhin pas deklarimit publik të fitimit ose të informacioneve të tjera të përzgjedhura financiare.

Korrigjimi i ngjarjeve pas datës së bilancit

8. Një njësi ekonomike do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarje të korrigjueshme pas datës së bilancit.

9. shembuj të ngjarjeve pas datës së bilancit që i kërkojnë një njësie ekonomike të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare, ose të njohë zëra që nuk janë njohur më parë:

(a) Shlyerja pas datës së bilancit të një çështje gjyqësore që konfirmon që një njësi ekonomike kishte një detyrim aktual në datën e bilancit. Njësia ekonomike korrigjon provizione të njohura më parë të lidhura me këtë çështje gjyqësore në përputhje me SNK 37 *Provizionet, Pasivet dhe Aktivet e kushtëzuara* ose të njohura si një provizion i ri. Njësia ekonomike nuk jep vetëm informacion shpjegues për një pasiv të kushtëzuar pasi shlyerja jep prova shtesë që do të shqyrtohen në përputhje me paragrafin 16 të SNK 37.

(b) marrja e informacionit pas datës së bilancit që tregon se një aktiv është dëmtuar në datën e bilancit, ose që shuma e humbjes nga çvlerësimi i njohur më parë për atë aktiv duhet të korrigjohet, për shembull:

Shembull:

(i) falimentimi i një klienti, që ka ndodhur pas datës së bilancit, në përgjithësi konfirmon se një humbje ka ekzistuar në datën e bilancit të llogarive të arkëtueshmë tregtare dhe se njësia ekonomike duhet të korrigojë vlerën kontabël (neto) të llogarive të arkëtueshme tregtare; dhe

(ii) shitja e inventarëve pas datës së bilancit mund të japë të dhëna rreth vlerës së tyre neto të realizueshme në datën e bilancit.

(c) përcaktimi pas datës së bilancit i kostos së aktiveve të blera ose i të ardhurave nga shitja e aktiveve përpara datës së bilancit.

(d) përcaktimi pas datës së bilancit i shumës së fitimit nga aksionet ose të pagesave të shumave nëse njësia ekonomike kishte një detyrim aktual ligjor ose një detyrim konstruktiv në datën e bilancit për të bërë pagesa të tilla si rezultat i ngjarjeve pas asaj date (SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*).

(e) zbulimi i mashtrimeve dhe gabimeve që tregojnë se pasqyrat financiare janë të pasakta.

Ngjarje që nuk korrighohen pas datës së bilancit

10. Një njësi ekonomike nuk do të korrighojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarje të pakorrighjueshme pas datës së bilancit.

11. Një shembull i ngjarjeve të pakorrighjueshme pas datës së bilancit është ulja e vlerës së tregut të investimeve ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë autorizuar për nxjerrje pasqyrat financiare. Ulja e vlerës së tregut normalisht nuk lidhet me kushtet e investimeve në datën e bilancit, por reflekton rrethana që kanë dalë më pas. Si rezultat, një njësi ekonomike nuk i korrighjon shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për investime. Në të njëjtën mënyrë, njësi ekonomike nuk i përditëson shumat e dhëna për investime në datën e bilancit, megjithëse ajo mund të duhet të japë informacione shpjeguese shtesë sipas paragrafit 21.

Dividentët

12. Nëse një njësi ekonomike i deklaron dividendët mbajtësve të instrumentave të kapitalit neto (siç përcaktohet në SNK 32 *Instrumente financiare*) pas datës së bilancit, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si pasivë në datën e bilancit.

13. Nëse janë deklaruar dividendët (dmth dividendët janë autorizuar ashtu siç duhet dhe nuk janë më në diskrecionin e njësisë ekonomike) pas datës së bilancit, por para autorizimit për publikim të pasqyrave financiare, dividendët nuk njihen si pasiv në datën e bilancit pasi ata nuk plotësojnë kriteret për një detyrim aktual në SNK 37. Dividentë të tillë jepen në shënime, në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.

Vijimësia

14. Një njësi ekonomike nuk do t'i përgatisë pasqyrat e saj financiare mbi një bazë vijimësie nëse struktura drejtuese përcakton se pas datës së bilancit ajo ose ka si qëllim të likujdojë njësinë ekonomike ose së ndalojë të tregëtuarit, ose se ajo nuk ka alternativa të tjera reale.

15. Prishja e rezultateve operative dhe pozicioni financiar pas datës së bilancit mund të dëshmojnë nevojën për të shqyrtuar nëse supozimi i vijimësisë është ende i përshtatshëm. Nëse supozimi i vijimësisë nuk është më i përshtatshëm, efekti është kaq bindës sa që këtij standardi i duhen ndryshime bazë në bazën e kontabilitetit, dhe jo një korigjim i shumave të njohura brenda bazës origjinale të kontabilitetit.

16. SNK 1 specifikon informacionin e kërkuar shpjegues nëse:

- (a) Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur mbi një bazë vijimësie; ose
- (b) Struktura menaxhuese është e ndërgjegjshme për pasiguritë materiale të lidhura me ngjarje ose kushte që mund të hedhin një dozë domethënëse dyshimi mbi aftësinë e një njësie ekonomike të vazhdojë në vijimësi. Ngjarjet ose kushtet që kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese mund të ndodhin pas datës së bilancit.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Data e autorizimit për publikim

17. Një njësi ekonomike jep informacion rreth datës kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare dhe kush e ka dhënë autorizimin. Nëse pronarët ose persona të tjerë të njësisë ekonomike kanë kompetenca për të ndryshuar pasqyrat financiare pas publikimit, njësia ekonomike do të japë informacion rreth këtij fakti.

18. Është e rëndësishme për përdoruesit të dinë se kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare, pasi pasqyrat financiare nuk reflektojnë ngjarje pas kësaj date.

Ngjarje që nuk korrighohen pas datës së bilancit

21. Nëse ngjarje që nuk korrighohen pas datës së bilancit janë materiale, mosdhënia e informacioneve shpjeguese mund të ketë ndikim mbi vendimet ekonomike të marra nga pëdoruesit në bazë të pasqyrave financiare. Si rrjedhim, një njësi ekonomike jep informacionin e mëposhtëm shpjegues për secilën kategori materiale të ngjarjeve të pakorrighjueshme pas datës së bilancit:

(a) natyra e ngjarjes; dhe

(b) një vlerësim të efektit të saj financiar, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.

22. Shembuj të ngjarjeve të pakorrigjueshme pas datës së bilancit, të cilat në përgjithësi do të rezultojnë në dhënie informacionesh shpjeguese:

(a) një kombinim i madh biznesi pas datës së bilancit (SNRF 3 *Kombinime biznesi* kërkon informacione specifike shpjeguese në raste të tilla) ose disponimin e një filiali kryesor;

(b) deklarimin e një plani për të ndërprerë një operacion;

(c) blerje të mëdha aktivesh, klasifikim i aktiveve për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet jo të Vijueshme*, cvlerësime të tjera në aktiveve ose shpronësim i aktiveve kryesore nga Qeveria;

(d) shkatërrimi i një fabrike kryesore prodhimi nga zjarri pas datës së bilancit;

(e) deklarimi ose fillimi i zbatimit të një ristrukturimi kryesor (shih SNK 37);

(f) transaksione kryesore aksionesh të zakonshme dhe transaksione aksionesh të zakonshme potenciale pas datës së bilancit (SNK 33 *Fitimet për aksion* i kërkon një njësie ekonomike të japë informacion shpjegues në formën e një përshkrimi për transaksione të tilla, me përjashtim të rasteve kur transaksionet përfshijnë kapitalizime ose emetime falas (aksione, obligacione),, ndarje të aksionit ose ndarje të aksionit rezervë, të cilat të gjitha kërkohej të korrigjohen sipas SNK 33);

(g) ndryshime të mëdha anormale pas datës së bilancit në cmimet e aktiveve ose kurset e këmbimit të monedhave të huaja;

(h) ndryshime në nivelin e tatimeve ose ligjet e tatimeve, të hyra në hyqi ose të deklaruara pas datës së bilancit, të cilat kanë një ndikim material mbi aktivet dhe pasivet aktuale për tatime ose aktivet dhe pasivet e shtyra (shih SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*);

(i) hyrja në angazhime të konsiderueshme ose detyrime eventuale, për shembull, duke dhënë garanci të konsiderueshme; dhe

(j) fillimi i zgjidhjeve të konflikteve të mëdha të dala vetëm nga ngjarjet e ndodhura pas datës së bilancit.

Data e hyrjes në fuqi

23 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Tërheqja e SNK 10 (e rishikuar 1999)

24 Ky Standard zëvendëson SNK 10 *Ngjarje pas datës së bilancit* (i rishikuar në 1999).

**Ju faleminderit për
vëmendje**